



# Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë 2011

**Kontakt:** Tel/fax: + 355 4 2245078; Mob. + 355(0)692469393; (0)682039297;  
E-mail: koalicioni2011@gmail.com;  
Website: www.zgjedhje.al;

## DEKLARATË

### **Standartet e procesit zgjedhor në pikëpyetje nga rezultati i Bashkisë Tiranë**

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë po monitoron me vëmendje ecurinë e procesit zgjedhor në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve si dhe në ZAZ nr. 49 ku ende vazhdon procesi i numërimit për Kryetarin dhe Këshillin e Njesisë Bashkiake Nr. 5 në Tiranë.

Pas publikimit të Deklaratës dhe Konstatimeve Paraprake më 10 maj 2011, nëpërmjet prononcimeve publike të përfaqësuesve të Koalicionit në media të ndryshme janë dhënë konsiderata, vërejtje dhe sugjerime në lidhje me ecurinë në vazhdimësi të procesit.

I shqetësuar nga zhvillimet e fundit, Koalicioni vlerëson paraprakisht se mungesa e një rezultati për Bashkinë Tiranë, ende pas 11 ditësh nga dita e votimit, veprimet joligjore të ndërmarra nga KQZ, situata e tensionuar pranë KQZ-së apo edhe protestat e ndërmarra nga opozita, po vënë në pikëpyetje plotësimin e standarteve të procesit zgjedhor si dhe vetë sistemin zgjedhor.

Forcat politike gjatë gjithë kësaj periudhe kanë influencuar në mënyrë direkte ndaj përfaqësuesve të tyre në Grupet e Numërimit të Votave dhe anëtarët e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor për të zvarritur pa shkak procesin e numërimit<sup>1</sup> duke krijuar dhe rritur artificialisht tensionin pranë dhe brenda Vendeve të Numërimit të Votave.

Tensioni u rrit edhe si pasojë e rezultateve kontradiktore të numërimit që vinin nga partitë politike, në mungesë të transparencës dhe publikimit të të dhënave në kohë reale nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, çka u mbulua nga kontributi i pazëvendësueshëm i disa mediave që e kryen këtë proces në kohë reale dhe me profesionalizëm.

Presioni është rritur ndjeshëm sidomos pas përfundimit të numërimit të Qendrës së fundit të Votimit dhe publikimit të rezultetit paraprak për Kryetarin e Bashkisë Tiranë.

Diferenca prej 10 votash në rezultatin përfundimtar paraprak midis dy kandidatëve garues për kryetarin e bashkisë Tiranë është një diferencë tepër e vogël në Bashkinë e Tiranës e cila përmban 485 qendra votimi dhe ku janë konstatuar 6699 vota të pavlefshme, ose 2.6 % e votave të numëruara për kryetar të Bashkisë Tiranë.

Ky rezultat priret të jetë i kontestuëshëm në të gjitha këndvështrimet, qoftë edhe statistikisht nga pikëpamja e probabilitetit të gabimit njerëzor<sup>2</sup> dhe mund të quhet përfundimtar pasi të mbarojë edhe procesi i ankimimit të mundshëm në KQZ apo në Kolegj Zgjedhor.

Prononcimet e parakohshme publike në lidhje me rezultatin, të kryetarit të mazhorancës dhe opozitës kanë marrë trajtat e presionit të hapur politik mbi punën e institucioneve të administrimit zgjedhor.

<sup>1</sup> Kjo është vërejtur sidomos në ZAZ e Njësive Bashkiake nr. 5, 8, 9 dhe 10.

<sup>2</sup> Kjo diferencë është e barabartë me 0.0039 % të votave të hedhura në kuti.

### Mbështetur financiarisht nga:

Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci pranë Ambasadës së SHBA-së, Tiranë,  
USAID si dhe Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë OSFA (Soros).

**Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit apo donatorëve të mësipërm.**



# Koalicioni i Vëzhguesve Vendore 2011

**Kontakt:** Tel/fax: + 355 4 2245078; Mob. + 355(0)692469393; (0)682039297;  
E-mail: koalicioni2011@gmail.com;  
Website: www.zgjedhje.al;

Si rezultat i këtij presioni dhe njoftimit për nisjen e procedurave joligjore të propozuar nga anëtarët e propozuar nga mazhoranca në KQZ, deputetët e opozitës në mënyrë të panevojshme, e kanë rritur akoma më tej tensionin politik duke hyrë në ambientet e KQZ dhe penguar vijueshmërinë normale të punës së tij në pasditen e datës 17 maj 2011.

Koalicioni i konsideron thirrjet nga eksponentë të opozitës ndaj qytetarëve për të protestuar dhe synimin e tyre për të hyrë me forcë në ambientet e KQZ si të pajustificueshme dhe provokuese, përsa kohë që opozita ndodhet e përfaqësuar pranë këtij komisioni me anëtarët e propozuar nga vetë ajo, si dhe nga përfaqësuesit politikë të saj të akredituar aty, ndërkohë që sistemi ligjor dhe demokratik i vendit siguron mekanizmat e nevojshëm për gjetjen e zgjidhjeve ligjore dhe kushtetuese.

Ndërkohë, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve nën autoritetin dhe protagonizmin e Kryetarit të tij, jo vetëm që është duke ndërmarrë veprime antiligjore, por përgjatë procesit të hapjes dhe verifikimit të votave të kontestuara apo të pavlefshme, po konstatohen fakte serioze që ngrenë dyshime mbi sigurinë dhe përpjekshmërinë e kutive të votimit.

## **I. Ecuria e procesit të numërimit për Bashkinë e Tiranës**

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve me vendimin<sup>3</sup> e tij nr. 541, udhëzoi kryerjen e procesit të numërimit në KZAZ e Njësisë Bashkiake në Tiranë<sup>4</sup>, duke filluar me numërimin e votave për Kryetarin e Bashkisë Tiranë dhe Këshillit Bashkiak Tiranë, ndryshe nga sa parashikohet në Kodin Zgjedhor Neni 116 pika 1, me synimin e kryerjes sa më shpejt dhe me lehtësi të procesit të numërimit në Tiranë, ku çdo Qendër Votimi ka katër kuti votimi<sup>5</sup>.

Pavarësisht kësaj, rezultoi se procesi i numërimit, si pasojë e kërkesave aspak reale dhe thellësisht politike, u zvarrit për më shumë se gjashtë ditë, duke përfunduar vetëm falë kontributit të paçmueshëm të përfaqësuesve të trupit diplomatik dhe organizmave ndërkombëtarë, të cilët me prezencën e tyre të gjatë si vëzhgues pranë këtyre VNV-ve ndikuan jo vetëm për mbylljen e shpejtë të tij, por edhe në uljen e ndjeshme të tensionit dhe të mbajtjes në kontroll të militantëve të të dy kampeve politike.

Partitë politike nuk morrën përsipër përgjegjësitë e tyre për administrimin dhe vlerësimin sa më të shpejtë të votave të qytetarëve.

Në Vendet e Numërimit të Votave u vërejt një prezencë e madhe e personaliteteve politike si deputetë të opozitës dhe mazhorancës, qeveritarë, etj, të cilët, në disa raste në mënyrë abuzive, nuk respektuan dispozitat e Kodit Zgjedhor për akreditimin e tyre apo të shoqëruesve të tyre pranë KZAZ-ve përkatëse dhe nuk respektuan numrin e limituar të vëzhguesve partiakë, sipas përcaktimeve ligjore në Kod për vëzhguesit e Koalicioneve Elektorale.

Prezenca e madhe dhe deklaratat e nxituara të këtyre personave në disa raste u bënë shkak i tensionimit të situatës apo edhe për ndodhjen e disa konflikteve të vogla.

<sup>3</sup> Vendimi Nr. 541, datë 06.05.2011 “Për caktimin e rradhës së procesit të numërimit të votave, për KZAZ-të e njësisë bashkiake të Bashkisë Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 8 maj 2011”

<sup>4</sup> ZAZ Nr. 45 – 55, përkatësisht për Njësitë Bashkiake Nr. 1 - 11

<sup>5</sup> Kutia e Votimit për Kryetar të Bashkisë Tiranë; për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Tiranë; për Kryetar të Njësisë Bashkiake dhe Kutia për Këshillin e Njësisë Bashkiake.

## **Mbështetur financiarisht nga:**

Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci pranë Ambasadës së SHBA-së, Tiranë,  
USAID si dhe Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë OSFA (Soros).

***Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit apo donatorëve të mësipërm.***



# Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë 2011

**Kontakt:** Tel/fax: + 355 4 2245078; Mob. + 355(0)692469393; (0)682039297;  
E-mail: koalicioni2011@gmail.com;  
Website: www.zgjedhje.al;

Në mjaft raste u vërejt se këta persona kontestonin pa arsye dhe në mënyrë abuzive votat që numëronin Grupet e Numërimit të Votave duke sjellë bllokimin e procesit të numërimit.

Deklaratat zyrtare të partive politike e në veçanti të opozitës për mbledhjen e qytetarëve pranë VNV-ve për ruajtjen e votës ishin provokuese dhe të pajustificueshme.

Përbërja e Grupeve të Numërimit të Votave me zyrtarë lokalë apo qëndrorë evidentoi qartësisht politizimin e skajshëm të punës së këtyre grupeve në vlerësimin dhe numërimin e votave të qytetarëve.

Në disa raste KZAZ-të, pa asnjë shkak dhe duke shkelur Kodin Zgjedhor krijuan vështirësi për prezencën e vëzhguesve të Koalicionit në Vendet e Numërimit të Votave, ndërkohë që nuk u evidentua asnjë rast ku KZAZ-të të merrnin masa për vëzhgues të akredituar nën siglën e subjekteve të tjera dhe që vepronin në mënyrë të hapur si vëzhgues të forcave politike.

## **II. Shpallja e rezultatit paraprak për Kryetarin e Bashkisë Tiranë**

Interpretimi i pasaktë mbi rezultatit përfundimtar paraprak për kryetarin e Bashkisë Tiranë shkaktoi konfuzion dhe tension real midis militantëve dhe përkrahësve të të dy kampeve politike, në lidhje me atë se kush fitoi realisht kreun e Bashkisë Tiranë.

Koalicioni përshëndeti daljen publike të kreut të mazhorancës, në pozicionin e Kryeministrit të vendit, për ruajtjen e qetësisë dhe pritjen e rezultatit përfundimtar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, sikundër parashikohet në Kodin Zgjedhor.

Por ky prononcim u shtri më tej duke dhënë opinionin e tij se si tabelat përfundimtare duhet të përqaseshin me rezultatet e çdo qendre votimi, ndërkohë që ky proces është tagër e KQZ-së dhe është qartësisht i shprehur në ligj.

Në mënyrë të pajustificueshme disa KZAZ të njëjësive bashkiake në Tiranës vonuan dorëzimin e tabelës përmbledhëse pranë KQZ-së duke e mbyllur këtë proces më datën 16 maj 2011.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, pavarësisht kërkesave të bëra nga Koalicioni shumë kohë para ditës së zgjedhjeve për miratimin e tabelës përmbledhëse për Bashkinë e Tiranës, vetëm në datën 16 maj e miratoi këtë model të tabelës përmbledhëse<sup>6</sup>, duke mospërdorur termin “Bashkia e Tiranës” sikundër e ka përdorur në aktet e mëparshme por duke e quajtur “Zona Zgjedhore Bashkia Tiranë”.

Koalicioni konsideron me shqetësim se artikulli në vazhdimësi i Kryeministrit të vendit në lidhje me procesin e papërfunduar të shpalljes së rezultatit për Kryetarin e Bashkisë Tiranë është një ndërhyrje direkte në punën e pavarur të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Kryetari i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, në tejkallim të kompetencave të tij, deklaroi se do të ndërmerre hapat e nevojshëm për vlerësimin e të gjitha votave të qytetarëve të cilat ishin në kuti të gabuara.

<sup>6</sup> Vendimi Nr . 650, datë 16.05.2011 “Për miratimin e procedurave për nxjerrjen e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet vendore 2011”

### **Mbështetur financiarisht nga:**

Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci pranë Ambasadës së SHBA-së, Tiranë,  
USAID si dhe Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë OSFA (Soros).

**Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit apo donatorëve të mësipërm.**



# Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë 2011

**Kontakt:** Tel/fax: + 355 4 2245078; Mob. + 355(0)692469393; (0)682039297;  
E-mail: koalicioni2011@gmail.com;  
Website: www.zgjedhje.al;

## **Rivlerësimi i fletëve të votimit jo në kutitë përkatëse**

Koalicioni konsideron paraprakisht se e drejta e votës është një ndër të drejtat thellore të individit në një shoqëri demokratike.

Respektimi dhe sanksionimi i kësaj të drejte është materializuar në Kodin Zgjedhor nga Kuvendi i Shqipërisë si edhe në udhëzimet përkatëse në zbatim të Kodit të nxjerra nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Në një shtet demokratik e ligjor respektimi i së drejtës nëpërmjet një procedure ligjore është element thelbësor dhe jetik për demokracinë dhe institucione të konsoliduara.

Koalicioni vlerëson se fenomeni i hedhjes së fletëve të votimit në kutinë e gabuar nuk është një risi për administratorët e zgjedhjeve në Tiranë dhe nuk mund të pretendohet për ta respektuar atë vetëm pas shpalljes së rezultatit për kryetarin e bashkisë së Tiranës, ndërkohë që KQZ ka qenë në dijeni dhe ka udhëzuar GNV-të për konsiderimin e tyre të pavlefshme, çka ka ndodhur me të gjitha fletët e tilla, të cilat janë konsideruar fletë votimi të pavlefshme në mënyrë unanime nga të gjithë komisionerët, deri në momentin e shpalljes së rezultatit përfundimtar paraprak midis dy kandidatëve.

Në ditën e Votimit më datën 8 Maj, Koalicioni në bazë të të dhënave të raportuara nga vëzhguesit për ngatërrimin e votuesve në hedhjen e fletëve të votimit në kutitë respektive, i kërkoi publikisht Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, nëpërmjet një konference shtypi, që të merrte urgjentisht masa dhe të nxirrte një udhëzim të posaçëm për konsiderimin të vlefshëm të çdo vote ku shprehej qartë vullneti i zgjedhësit, pavarësisht kutisë në të cilën ishte hedhur.

Koalicioni e justifikoi këtë kërkesë me mungesën e fushatës së sensibilizimit për votuesit e Bashkisë Tiranë të cilët do të votonin në katër kuti, si dhe me faktin e ngjyrave të ngjashme të shenjave dalluese në kutitë e votimit, për më tepër që kishte disa qendra votimi ku shenjat dalluese në kutitë e votimit mungonin tërësisht.

Madje, u evidentuan disa raste kur qytetarët kuptuan në kohë hedhjen e pakujdesshme të fletës së votimit në kutinë e gabuar, dhe meqënëse në udhëzimet e dhëna nga KQZ në trajnimet e kryera për konsiderimin të pavlefshëm të çdo flete votimi të gjendur në kutinë e gabuar, Koalicioni i kërkoi KQZ- së që meqënëse këto fletë ishin të pavlefshme, të udhëzoheshin Komisionet e Qendrave të Votimit që t'u jepej sërish qytetarëve mundësia të merrnin një fletë tjetër votimi. KQZ nuk morri asnjë masë në lidhje me këtë çështje.

Komisionerët e KZAZ-ve dhe anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave, deri në momentin e publikimit të rezultatit paraprak për kryetarin e Bashkisë Tiranë, në mënyrë konsesuale dhe pa asnjë kontestim në ndjekje të udhëzimeve të marra nga trajnimet e kryera nga inspektorët e KQZ-së, i konsideruan të gjitha fletët e votimit në kutitë e gabuara si të pavlefshme.

## **Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve**

Më datën 17 maj KQZ futi në rendin e ditës vendimin "Për vlerësimin e fletëve të Votimit për Kryetarin dhe Këshillin e Bashkisë Tiranë të cilat gjenden në kutitë".

Sipas informacioneve të marra nga vëzhguesit tanë, ky vendim është iniciuar nga disa Kërkesa që kanë paraqitur KZAZ nr. 46, 47, 48, 49, 51, 53, 54 dhe 55 për rivlerësimin e fletëve të votimit për kryetarin e Bashkisë Tiranë të gjetura në 60 Kuti Votimi të njëjësive bashkiake, ku, sipas

### Mbështetur financiarisht nga:

Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci pranë Ambasadës së SHBA-së, Tiranë,  
USAID si dhe Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë OSFA (Soros).

**Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit apo donatorëve të mësipërm.**





# Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë 2011

**Kontakt:** Tel/fax: + 355 4 2245078; Mob. + 355(0)692469393; (0)682039297;  
E-mail: koalicioni2011@gmail.com;  
Website: www.zgjedhje.al;

tyre, janë evidentuar vetëm vota të qarta për kryetarin e Bashkisë Tiranë<sup>7</sup>, të cilat KZAZ-të, në pamundësi të vlerësimit të këtyre fletëve, pasi tabelat përmbledhëse për Kryetarin e Bashkisë së Tiranës janë mbyllur, i kërkohet KQZ që t'i vlerësojë dhe konsiderojë këto vota. Këto Kërkesa janë firmosur vetëm nga anëtarët e mazhorancës në këto KZAZ.

Për shkak të hyrjes të të gjithë deputetëve të opozitës në sallën e mbledhjeve të KQZ-së ky vendim u shqyrtua ditën e nesërme datë 18 Maj 2011.

Kryetari i KQZ-së në shkelje të të gjitha procedurave ligjore, kaloi vetëm në parim këtë vendim pa e kaluar nen për nen, madje në draft-vendimin e paraqitur mungon pjesa e neneve që përcaktojnë këtë vendim.

Ky vendim u miratua në parim me katër votat e anëtarëve të propozuar nga mazhoranca, pavarësisht se, si akt normativ, kërkon një shumicë të cilësuar prej pesë votash. Në mënyrë të menjëhershme pas kalimit në parim dhe pa një vendim paraprak KQZ solli në sallën e mbledhjeve të KQZ kutitë e votimit me fletët e kontestuara dhe të pavlefshme dhe filloi vlerësimin e tyre, proces i cili vazhdon ende.

Në diskutimet mbi ligjshmërinë e këtij akti, Kryetari i KQZ e konsideron një situatë të re ligjore dhe se KQZ po vepron si KZAZ për Bashkinë Tiranë, çka bie ndesh me Kodin Zgjedhor. Në nenin 122 pika 6 dhe nenin 123 përcaktohet qartë roli i KQZ –së për nxjerrjen e rezultatin përfundimtar duke u bazuar në Tabelat Përmbledhëse të Rezultateteve të 11 KZAZ-ve në Tiranë. Ndërkohë, në nenin 2 pika 8 dhe në nenin 27 pika 4 përcaktohet qartë se Zonat e Administrimit Zgjedhor në Bashkinë e Tiranës janë vetëm 11 Njësitë Bashkiake. Konsiderimi i KQZ si KZAZ për Bashkinë Tiranë është një koncept aspak i bazuar në ligj, madje abuziv, pasi në këtë rast KZAZ e Tiranës ka kompetenca më të fuqishme se KZAZ-të e tjera në marrjen në shqyrtim të vendimeve të tyre apo të ndryshimit të tabelave të rezultateve, të cilat janë tagër i Grupeve të Numërimit të Votave.

KQZ, vetëm më katër votat e anëtarëve të propozuar nga mazhoranca, po vlerëson fletët e votimit të kontestuara dhe të pavlefshme, sipas një informacioni paraprak të paraqitur në Kërkesat e bëra nga KZAZ-të e cituara më lart, dhe po ndryshon procesverbalet e grupeve të numërimit duke ia shtuar fletët e votimit të vlerësuar subjekteve apo kandidatëve garues në proces-verbalet përkatëse.

Përgjatë marrjes në shqyrtim të këtyre kutive të votimit, deri tani është konstatuar se: nuk merret në konsideratë kutia përkatëse e materialeve zgjedhore; kутisë së QV 1800 nuk i korrespondojnë kodet e vulave të sigurisë me të cilat i ka mbyllur Grupi i Numërimit të Votave; në kutinë e QV nr. 1797 doli një fletë votimi e QV nr. 1810/1 si dhe probleme të tjera të cilat po ngrënë dyshime mbi sigurinë dhe paprekshmërinë e kutive të votimit.

Koalicioni i konsideron hapat e ndërmarra nga KQZ dhe kryetari i saj si shkelje flagrante e ligjit zgjedhor.

<sup>7</sup> Në kërkesa specifikohet që këto vota janë vërejtur vetëm për kryetarin e bashkisë Tiranë ndërkohë që nga marrja në shqyrtim e tyre kanë rezultuar edhe vota për këshillin bashkiak.

#### Mbështetur financiarisht nga:

Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci pranë Ambasadës së SHBA-së, Tiranë, USAID si dhe Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë OSFA (Soros).

**Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit apo donatorëve të mësipërm.**



# Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë 2011

**Kontakt:** Tel/fax: + 355 4 2245078; Mob. + 355(0)692469393; (0)682039297;  
E-mail: koalicioni2011@gmail.com;  
Website: www.zgjedhje.al;

Sjellja e këtij Komisioni dhe kryetarit të tij duke marrë vendime të kundraligjshme me katër votat e anëtarëve të propozuar nga shumica, është qartësisht për motive dhe interesa politike, duke rrezikuar integritetin e procesit, sistemin zgjedhor dhe minuar besimin e qytetarëve në institucionet e pavaruara dhe rezultatin që do të çertifikohet.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve është institucioni garant dhe mbrojtës i interesave të qytetarëve përballë interesave të partive politike.

Ai është një organ kolegjal që synon realizimin e një procesi të drejtë e demokratik në respekt të vullnetit të qytetarit, duke drejtuar një administratë të tërë e cila nuk mund të kompromentohet nga vullneti individual i një anëtari të tij, qoftë ky edhe Kryetari.

## **Partitë politike**

Koalicioni i tërheq vëmendjen partive politike t'i japin fund ndërhyrjes dhe influencave në punën e institucioneve të administrimit zgjedhor.

Përfundimi dhe çertifikimi i procesit zgjedhor është një çështje thellësisht teknike që pasqyron vetëm vullnetin e votuesit dhe nuk është aspak çështje politike.

Koalicioni i kërkon Partisë Socialiste, Kreut të saj si dhe opozitës të ndalin protestat dhe të ndjekin hapat ligjorë duke shfrytëzuar të gjithë mekanizmat dhe hapësirat ligjore.

Besimi tek institucionet është element thelbësor që duhet nxitur dhe ushqyer tek qytetari për një shtet demokratik dhe shoqëri të përgjegjshme.

Koalicioni i kërkon Presidentit të Republikës të ushtrojë kompetencat e tij kushtetuese duke mos lejuar prekjen e integritetit të sistemit dhe futjen e vendit në një krizë të re politike.

**Tiranë më 19 Maj 2011**

## **Kontakt:**

### ***i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë 2011***

Gerta Meta (*Shoqata për Kulturë Demokratike (SHKD)*) mob. 0692469393  
Premto Gogo (*KRIIK Albania*) mob. 0682039297

Tel./fax: + 355 4 2245078;  
E-mail: koalicioni2011@gmail.com;  
Website: www.zgjedhje.al;

## **Mbështetur financiarisht nga:**

Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci pranë Ambasadës së SHBA-së, Tiranë,  
USAID si dhe Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë OSFA (Soros).

***Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë material nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit apo donatorëve të mësipërm.***